



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

VENDIM

Nr 48 datë 21/12/2016

**Për miratimin e Akt-Marrëveshjes mbi kuotën e anëtarësisë për financimin e
buxhetit të Qarkut nga Bashkitë**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 38 pika 3, të Ligjit nr.9936, datë 02.06.2008 "Për manaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; të Udhëzimit nr.2, datë.06.02.2012, "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" pika 121; Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 48, datë 21.12.2016 "Për Miratimin e Planit të Buxhetit të vitit 2017, si dhe të vendimeve të këshillave bashkiakë "Për Miratimin e Planit të Buxhetit të vitit 2017",

VENDOSI

1. Të miratojë Akt-Marrëveshjen mbi kuotën e anëtarësisë për financimin e buxhetit të Qarkut nga Bashkitë sipas lidhjes bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 78 pika 3 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".


SADRIT DANAJ
KRYETARI